



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



Në bazë të nenit 11, paragrafi 1, nenit 18, paragrafi 1 dhe 3, të Ligjit nr. 03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Komuna e Prishtinës, rishpallë këtë

K O N K U R S
PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

DREJTORIA E INSPEKSIONIT

POZITA: Inspektor të komunikacionit-dy (2) ekzekutues

KOEFICIENTI : 7

LLOJI I POZITËS: i karrierës

POZITA FUNKSIONALE: nëpunës civil i nivelit profesional

ORARI I PUNËS: 40 orë në javë

PËRGGJEGJËSIA MBIKËQYRËSE : po

MBIKËQYRJA: Shefi i Sektorit dhe Drejtori i drejtorisë.

DETYRAT E PUNËS:

- Mbikëqyrë zbatimin e dispozitave ligjore dhe dispozitave të tjera nga lëmi i qarkullimit të mjeteve motorike në komunikacionin rrugor, lidhur me atë se a i plotëson kushtet Stacioni i autobusëve dhe mjediset tjera për pritjen e udhëtarëve;
- Mbikëqyrë harmonizimin e dispozitave për mbrojtjen në qarkullimin publik;
- Mbikëqyrë dhe kontrollon dispozita tjera, të cilat parashihen me ligjin përkatës që rregullon çështjet e komunikacionit;
- Kryen edhe punë të tjera me kërkesën e shefit të Sektorit.

Kushtet: Përgatitja superiore- Fakulteti i Komunikacionit, F. i Makinerisë, 1 vit përvojë pune, shkathtësi personale.

Data e rishpalljes se Konkursit 21.08.2014 deri me dt. 04.09.2014

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në objektin e komunës së vjetër.

Në aplikacion duhet te ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkangjitura aplikacionit duhet te jenë kopje dhe nuk kthehen.

“ Shërbimi Civil i Komunës është në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe mirëpret aplikime nga meshkujt dhe femrat e të gjitha komuniteteve të Kosovës ”

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e rishpalljes për pozitën e cekur më lartë.

KPSHC (Komisioni përzgjedhës i shërbimit civil) duke u bazuar në nenin 25 paragrafi 1 të Rregullores NR. 02/2010 për procedurat e rekrutimit të shërbimit civil, mund të verifikoi me institucionet përkatëse vërtetësinë e të dhënave të sigurta nga kandidatët.

Pas përgatitjes së listës së ngushtë të kandidatëve, këtyre kandidatëve do të ju kërkohen kopjet e dokumenteve të vërtetuara nga organi kompetent(diploma dhe kontrata e punës ose vërtetimi i përvojës e punës) nëse ato nuk janë dorëzuar të vërtetuara.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, përvojës së punës, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit.

Fletë aplikacionet e kandidatëve me dokumente të pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit, nuk do të merren në shqyrtim.

Për çdo informatë plotësuese mund të kontaktoni me Njësinë e personelit, zyra nr. 40, në këtë nr. të telefonit 038 / 230 - 900 lokali 10 -70.